

URDHËR
Nr. 558, datë 28.10.2025

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT, KOPSHTI “ATE ANNIBALE DI FRANCIÀ”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe urdhrit nr. 497, datë 29.9.2025, të ministrit të Arsimit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “*Ate Annibale Di Francia*”, themeluar nga Fondacioni “Etërit Rogacionistë Shqiptarë”, i licencuar me urdhrin nr. 466, datë 22.12.2009, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar – kopshti ‘*Ate Annibale Di Francia*’”, me kërkesën e tij nr. 94/2 prot., datë 16.9.2025.

2. Institucioni arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “*Ate Annibale Di Francia*”, ka për detyrë:

a) të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

b) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer;

c) të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të arsimit parashkollor, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyllur, nëse ka.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lezhë ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “*Ate Annibale Di Francia*”;

b) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat;

c) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë, sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “*Ate Annibale Di Francia*”.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Lezhë të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “*Ate Annibale Di Francia*”, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lezhë të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 466, datë 22.12.2009, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar – kopshti ‘*Ate Annibale Di Francia*’”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Lezhë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lezhë, institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “*Ate Annibale Di Francia*”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani